

ZYRA PËR MONITORIMIN DHE LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE

Raporti mbi trafikimin e personave për vitin 2016

SHQIPËRIA: Grupi i 2-të

Shqipëria është vendburim dhe destinacion për burra, gra dhe fëmijë që i nënshtrohen trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe punës së detyruar. Gra dhe fëmijë shqiptarë bien pre e trafikimit kryesisht për qëllime shfrytëzimi seksual brenda Shqipërisë, në vendet fqinje Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe Greqi, si edhe në vende të tjera të Europës. Viktimat shqiptare dhe disa të huaja u nënshtrohen punës së detyruar në Shqipëri, veçanërisht në sektorin e turizmit. Fëmijët, përfshirë ata me origjinë etnike rome ose egjiptiano-ballkanike, i nënshtrohen lypjes me detyrim si edhe formave të tjera të punës së detyruar në Shqipëri dhe në vendet fqinje. Vajzat janë të prekshme nga trafikimi për qëllime shfrytëzimi seksual. Organizatat joqeveritare raportojnë rritje të numrit të fëmijëve shqiptarë të cilët i nënshtrohen punës së detyruar në Kosovë dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Gra dhe vajza shqiptare i nënshtrohen trafikimit për shfrytëzim seksual ose punës së detyruar pas martesave me mblesëri në Shqipëri dhe jashtë vendit. Në vitet e mëparshme disa shtetase të huaja nga vende evropiane i janë nënshtrohuar trafikimit për qëllime shfrytëzimi seksual në Shqipëri. Emigrantë nga Lindja e Mesme, Azia Qendrore dhe Afrika, veçanërisht sirianë, kalojnë përmes Shqipërisë për të arritur në Evropën Perëndimore dhe janë të prekshëm ndaj trafikimit, edhe pse policia akoma nuk ka identifikuar ndonjë të tillë si viktimë të trafikimit. Korrupsioni dhe shkalla e lartë e lëvizjeve brenda forcës policore pengojnë veprimtarinë për zbatimin e ligjit në lidhje me trafikimin.

Qeveria e Shqipërisë nuk i përmbush plotësisht standardet minimale për eliminimin e trafikimit. Megjithatë, ajo po bën përpjekje të mëdha për ta arritur këtë gjë. Qeveria përmirësoi përpjekjet për zbatimin e ligjit duke dënuar më shumë trafikantë se sa në vitin 2014, përfshirë disa trafikantë që detyronin fëmijë të lypnin. Por, qeveria e organizatat joqeveritare identifikuan më pak viktime dhe qeveria ndoqi penalisht më pak trafikantë të dyshuar se sa në vitin 2014. Qeveria pakësoi fondet drejt strehës shtetërore për viktimat e trafikimit, dhe shërbimet psikologjike, mjekësore e ato të riintegritimit në strehën shtetërore edhe pse të përmirësuara, ishin ende të pamjaftueshme. Financimet nga qeveria për strehat e organizatave joqeveritare mbetën të pamjaftueshme megjithëse qeveria financoi pagat e 12 anëtarëve të personelit në dy streha të organizatave joqeveritare. Qeveria vazhdoi të hetonte dhe dënonte viktimat për vepra të paligjshme të kryera si rrjedhojë e nënshtimit ndaj trafikimit, megjithëse ligji i përjashton viktimat nga dënimi për krime të kryera si rrjedhojë e shfrytëzimit të tyre. Qeveria kishte një strategji kombëtare dhe një plan veprimi 2014-2017 për të luftuar trafikimin, megjithëse këto

mbetën me financime të pamjaftueshme, dhe qeveria shtoi buxhetin e koordinatorit antitrafik. Koordinatori kombëtar mblodhi rregullisht palët që i përkasin mekanizmit kombëtar të referimit.

REKOMANDIME PËR SHQIPËRINË:

Mos dënoni viktimat për veprime të paligjshme të kryera si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e nënshtrimit ndaj trafikimit, veçanërisht viktimat e trafikimit për shfrytëzim seksual në prostitucion. Rritni financimet për strehat e menaxhuara nga organizatat joqeveritare për viktimat e trafikimit dhe siguroni fonde në mënyrë të rregullt. Përmirësoni shërbimet e siguruara në strehën shtetërore, veçanërisht shërbimet psikologjike, mjekësore dhe ato të riintegrit. Financoji njësi të lëvizshme të drejtuara nga grupe të shoqërisë civile dhe zbatimin e ligjit për të identifikuar viktimat si edhe trajtoni më shumë policinë, inspektorët e punës dhe zyrtarë të tjerë në frontin e identifikimit proaktiv të viktimave. Hetoni fuqishëm, ndiqni penalisht dhe dënoni trafikantët, përfshirë edhe zyrtarët bashkëfajtorë. Inkurajoni viktimat të ndihmojnë në ndjekjen penale të trafikuesve të tyre duke lehtësuar pjesëmarrjen në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe duke zgjeruar trajnimin për prokurorët që merren me dëshmitarët viktima. Rritni kapacitetin e policisë së kufirit dhe migracionit për të kontrolluar imtësisht migrantët e parregullt për tregues trafikimi dhe vazhdoni përpjekjet për të kontrolluar fëmijët e rrugës për shenja trafikimi.

NDJEKJA PENALE

Qeveria shtoi përpjekjet për zbatimin e ligjit kundër trafikimit. Nenet 110(a) dhe 128(b) të kodit penal ndalojnë trafikimin për shfrytëzim seksual dhe punë dhe përcaktojnë dënime me burgim prej tetë deri në 15 vjet. Këto nene janë mjaft të rrepta dhe ua kalojnë atyre të parashikuara për krime të tjera të rënda, si përdhunimi. Prokuroria për Krimet e Rënda hetoi 25 trafikantë të dyshuar në vitin 2015, një rënie nga 39 të dyshuar në vitin 2014. Policia e shtetit hetoi gjithashtu 90 trafikantë të dyshuar gjatë periudhës së raportimit. Qeveria nuk i organizoi të dhënat e zbatimit të ligjit për të treguar përpjekjet kundër trafikimit për shfrytëzim seksual dhe për punë të detyruar. Qeveria ndoqi penalisht 15 të pandehur në vitin 2015, një rënie kjo nga 18 në vitin 2014. Gjykatat dënuan 11 trafikantë, rritje krahasuar me nëntë raste në vitin 2014. Të gjithë trafikantët e gjetur fajtorë morën dënime me burgim që varionin nga gjashtë deri në 17 vjet, tre prej të cilave ishin nën dënimin minimal të parashikuar prej tetë vjet burg. Autoritetet vazhduan të ndiqnin penalisht disa trafikantë për krime më të lehta të "shfrytëzimit për prostitucion" përkundëjt atij të trafikimit, sepse dy ligjet kanë mbivendosje në disa pjesë. Shfrytëzimi për prostitucion mbart dënimin me dy deri në pesë vjet burg, dhe deri në 15 vjet burg për rrethana të rënda, dhe autoritetet shpesh aplikuan akuzën më të butë sepse

ishite më e lehtë të hetohej dhe ndiqej penalisht. Disa zyrtarë gjithashtu njohën si trafikim vetëm rastet që përfshinin lëvizje përmes kufirit. Policia e kufirit vazhdoi të kontrollonte imtësisht migrantët e parregullt në kufirin jugor me Greqinë për tregues trafikimi, dhe në shtator qeveria bëri një plan parashikimi për t'u përballur me fluksin e numrit të madh të migrantëve, gjë që kërkonte kontrollin e hollësishëm të të gjithë migrantëve për tregues trafikimi. Në vitin 2015, qeveria trajnoi 240 gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë policie mbi hetimin dhe ndjekjen penale të trafikantëve dhe identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave. Shkalla e lartë e lëvizjes së punonjësve dhe korrupsioni penguan efektshmërinë e trajnimit të policisë. Qeveria nuk raportoi ndonjë hetim, ndjekje penale apo dënime të punonjësve të qeverisë bashkëpunëtorë në rastet e trafikimit. Policia mori pjesë në dy operacione shumëkombëshe për zbatimin e ligjit, gjë e cila çoi në ndalimin e 10 trafikantëve shqiptarë të dyshuar.

MBROJTJA

Qeveria identifikoi dhe ndihmoi viktimat por vazhdoi të jepte fonde të pamjaftueshme për shërbimet ndaj tyre. Qeveria dhe organizatat joqeveritare identifikuan 109 viktimat trafikimi dhe viktimat të mundshme trafikimi në vitin 2015, një rënie nga 125 në vitin 2014. Nga këto, autoritetet u garantuan status zyrtar viktime 38 personave pasi ata ranë dakord t'i nënshtroheshin një interviste me përfaqësues të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve sociale, gjë që kërkohet për të marrë këtë status. Qeveria identifikoi 80 viktimat, organizatat joqeveritare identifikuan 27, dhe pati dy viktimat të vetëdeklaruar. Organizatat joqeveritare raportuan se mungesa e fondeve nga qeveria për njësitë e lëvizshme të drejtuara nga organizatat joqeveritare, të cilat janë përgjegjëse për identifikimin e pjesës më të madhe të viktimave, çoi në identifikimin e më pak viktimave. Nga të gjitha viktimat e identifikuar, 48 ishin minorenë dhe 87 ishin femra. Organizatat joqeveritare raportuan prirjet e mëposhtme mes viktimave të ndihmuara nga strehat e drejtuara nga organizatat joqeveritare: 67 për qind e viktimave ishin pre e trafikimit për shfrytëzim seksual, nëntë për qind ishin viktimat të trafikimit për punë dhe 16 për qind ishin viktimat të lypjes me detyrim; 86 për qind e viktimave ishin shfrytëzuar brenda Shqipërisë, 12 për qind jashtë dhe dy për qind si brenda vendit dhe jashtë. Katër streha, tre prej të cilave drejtohen nga organizatat joqeveritare dhe një shtetërore, siguruan ndihmë për viktimat e trafikimit, përfshirë ushqimin, këshillimin, ndihmën ligjore, kujdesin mjekësor, shërbimet e arsimit, shërbimet e punësimit, ndihmë për fëmijët e viktimave, mbështetje financiare, akomodim afatgjatë, aktivitete sociale, trajnim profesional dhe interesim pas integritit. Megjithatë, organizatat joqeveritare raportuan se qeveria nuk siguroi mbështetje të mjaftueshme financiare për zbatimin e shërbimeve mjekësore, psikologjike dhe atyre të riintegritit. Strehat e organizatave ndihmuan 89 viktimat, dhe streha shtetërore ndihmoi 20. Qeveria dha 11.3 milionë lekë (93 mijë dollarë) për strehën shtetërore

në vitin 2015, rënie e konsiderueshme nga 19.77 milionë lekë (163 mijë dollarë) në vitin 2014. Qeveria nuk dha fonde të mjaftueshme për strehat e organizatave, duke caktuar 3 milionë lekë (24 mijë e 700 dollarë) vetëm për shpenzime ushqimore. Megjithatë, qeveria dha gjithashtu fonde për pagat e 12 anëtarëve të personelit në dy streha të organizatave dhe dha fonde për rinovimin e strehës shtetërore. Strehat e organizatave joqeveritare vazhduan të vepronin nën kufizime të mëdha financiare gjatë gjithë vitit 2015 dhe u mbështetën në burime të jashtme për kostot e veprimtarisë ditore. Nga 25 milionë lekët (206 mijë dollarë) në Fondin e Veçantë të qeverisë për Parandalimin e Krimit, 5 milionë lekë (41 mijë dollarë) iu dhanë OJQ-ve për të mbështetur viktimat e krimit. Megjithatë, asnjë fond nuk shkoi për mbështetjen e siguresve të shërbimeve për viktimat e trafikimit. Vetëm një strehë e drejtuar nga një organizatë joqeveritare dha shërbime të specializuara për të mitur që ishin viktimat e trafikimit dhe vazhdoi të operonte pa fonde të mjaftueshme. Viktimat e huaja patën mundësi të përdornin shërbime të njëjta si edhe viktimat shqiptare, përfshirë edhe ndihmën ligjore. Viktimat meshkuj u akomoduan në apartamente të paguara nga organizatat joqeveritare. Qeveria dha karta shëndeti për viktimat e trafikimit nëpërmjet të cilave sigurohet akses falas i kujdesit shëndetësor. Qeveria ndërmori një program që nxiste kompanitë të punësonin ish-viktima të trafikimit, por vëzhguesit vazhduan të raportonin se disa kompani detyronin ish-viktimat të punonin pa kompensimin e duhur.

Njësitë e zbatimit të ligjit dhe punonjësit socialë për mbrojtjen e fëmijëve kishin rol të drejtpërdrejtë në identifikimin e viktimave të mitur dhe sigurimin e mbrojtjes së tyre megjithëse ata ishin të keqfinancuar dhe me mungesë stafi. Një njësi e lëvizshme e drejtuar nga organizata joqeveritare identifikoi 13 viktimat e mundshme trafikimi në vitin 2015 pasi mori fonde nga qeveria çeke për të vazhduar shërbimet gjatë vitit. Organizatat raportuan se në shumicën e rasteve autoritetet nuk identifikuan formalisht viktimat gjatë hetimeve, duke i etiketuar rastet si “shfrytëzim prostitucioni.” Kjo gjë pengoi intervistat formale për të identifikuar viktimat, i bëri viktimat objekt të ndjekjes penale për krime të kryera si rrjedhojë e shfrytëzimit të tyre, si edhe i pengoi të merrnin shërbime në lidhje me trafikimin. Viktimat që dëshmuuan kundër trafikantëve patën mundësi përfshirjeje në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, por asnjë viktimë trafikimi nuk mori pjesë në këtë program, dhe organizatat raportuan së paku një rast kur zbatuesit e ligjit dekurajuan një viktimë nga marrja e këtij shërbimi pas dëshmisë. Dyzet e tetë viktimat dëshmuuan kundër trafikantëve. Ligji u dha viktimave të huaja një periudhë reflektimi prej tre muajsh me status rezidenti të përkohshëm dhe autorizim për të punuar deri në dy vjet, megjithëse qeveria nuk kishte garantuar akoma një status të tillë për ndonjë viktimë. Viktimat mund të merrnin dëmshpërblim nga qeveria ose të bënin padi civile kundër trafikantëve, por asnjë viktimë nuk mori dëmshpërblim në vitin 2015. Ligji i përjashtoi viktimat nga dënimi për krime të kryera si rrjedhojë e shfrytëzimit të tyre,

por strehat e drejtuara nga organizatat joqeveritare raportuan se qeveria dënoi tre viktima të identifikuara formalisht si viktima të trafikimit për shfrytëzim seksual në prostitucion.

PARANDALIMI

Qeveria vazhdoi përpjekjet për të parandaluar trafikimin. Qeveria kishte një strategji kombëtare dhe plan veprimi 2014-2017 për të luftuar trafikimin. Megjithatë, secila ministri palë e këtij plani ishte në mungesë fondesh për veprimtaritë e trafikimit, dhe disa prej tyre i përdorën fondet e trafikimit për qëllime të tjera. Qeveria shtoi fondet për zyrën e koordinatorit kombëtar antitrafik në 5.2 milion lekë (43 mijë dollarë) në vitin 2015 nga 4.7 milion lekë (39 mijë dollarë) në vitin 2014. Koordinatori kombëtar vazhdoi të botonte rregullisht raportin mbi veprimtarinë në faqen e internetit dhe rregullisht bëri bashkë palët që ishin pjesë e mekanizmit kombëtar të referimit. Dymbëdhjetë komisione rajonale antitrafik të përbëra nga zyrtarë lokalë dhe organizata joqeveritare punuan për parandalimin dhe ndihmën për viktimat, por efektshmëria e këtyre komisioneve në mbarë vendin ka qenë e kufizuar. Zyra e koordinatorit kombëtar, policia e shtetit dhe prokuroria e përgjithshme firmosën një memorandum mirëkuptimi për monitorimin e performancës së sistemit gjyqësor penal në zgjidhjen e çështjeve të trafikimit. Qeveria bashkëpunoi në vendosjen e një linje telefonike falas dhe e reklamoi atë si edhe një aplikacion celulari ku shtetasit mund të raportnin raste të dyshuara për trafikim. Ky numër mori 492 telefonata gjatë vitit 2015, 11 prej të cilave dhanë informacion në lidhje me raste të mundshme trafikimi. Zyra e Koordinatorit Kombëtar mbajti dy fushata të mëdha antitrafikim gjatë vitit 2015. E para, e mbajtur nga qershori deri në gusht, u përqendrua tek shfrytëzimi seksual dhe puna e detyruar e të miturve dhe përfshiu ndërgjegjësimin në shkolla dhe qendra komunitare, diskutime me nxënës të shkollave të mesme, konferenca dhe seminare me policinë e shtetit dhe atë kufitare dhe shërbimet sociale, si edhe takime për ndërgjegjësimin e të rinjve të cilat specifikisht synonin të arrinin popullsinë rome. Për fushatën e dytë, zyra e koordinatorit kombëtar përcaktoi tetorin si muajin antitrafik dhe organizoi një sërë aktivitete me mbështetjen financiare të organizatave joqeveritare. Qeveria nuk shfaqti përpjekje për të ulur kërkesën për seks me pagesë dhe punë të detyruar. Qeveria dha udhëzime antitrafikim për personelin e saj diplomatik, dhe koordinatori kombëtar mbajti një prezantim mbi rregulloren e trafikimit të qenieve njerëzore para diplomatëve shqiptarë të vendosur në nëntë qytete.

###

2016 Trafficking in Persons Report

ALBANIA: Tier 2

Albania is a source and destination country for men, women, and children subjected to sex trafficking and forced labor. Albanian women and children are primarily subjected to sex trafficking within Albania; in bordering Kosovo, Macedonia, Montenegro, and Greece; and in other European countries. Albanian and some foreign victims are subjected to forced labor in Albania, particularly in the tourism industry. Children, including those of Romani or Balkan Egyptian ethnicity, are subjected to forced begging and other forms of compelled labor in Albania and neighboring countries; girls are vulnerable to child sex trafficking. NGOs report an increase in the number of Albanian children subjected to forced labor in Kosovo and the United Kingdom. Albanian women and girls are subjected to sex trafficking or forced labor following arranged marriages in Albania and abroad. In past years, some foreign women from European countries were subjected to sex trafficking in Albania. Middle Eastern, Central Asian, and African migrants, particularly Syrians, transit Albania to reach Western Europe and are vulnerable to trafficking, although police have yet to identify any as trafficking victims. Corruption and high rates of turnover within the police force inhibit law enforcement action to address trafficking.

The Government of Albania does not fully meet the minimum standards for the elimination of trafficking; however, it is making significant efforts to do so. The government improved law enforcement efforts by convicting more traffickers than in 2014, including some traffickers who forced children to beg; but the government and NGOs identified fewer victims, and the government prosecuted fewer suspected traffickers than in 2014. The government decreased funding to the state-run shelter for trafficking victims; and psychological, medical, and reintegration services at the state-run shelter, though improved, were still inadequate. Government funding to NGO shelters remained insufficient, although the government funded the salaries of 12 staff members at two NGO shelters. The government continued to investigate and punish victims for unlawful acts committed as a result of being subjected to trafficking, although the law exempts victims from punishment for crimes committed as a result of their exploitation. The government had a 2014-2017 national strategy and action plan to combat trafficking, although it remained underfunded, and it increased the budget of the anti-trafficking coordinator. The national coordinator regularly convened stakeholders belonging to the national referral mechanism.

RECOMMENDATIONS FOR ALBANIA:

Do not punish victims for unlawful acts committed as a direct result of being subjected to trafficking, particularly sex trafficking victims exploited in prostitution;

increase funding to NGO-run shelters for trafficking victims and provide funding on a regular basis; improve services provided at the state-run shelter, particularly medical, psychological, and reintegration services; fund mobile units operated by civil society groups and law enforcement to identify victims and further train police, labor inspectors, and other front-line officials on proactive identification of victims; vigorously investigate, prosecute, and convict traffickers, including complicit officials; encourage victims to assist in the prosecution of their traffickers by facilitating participation in the witness protection program and expanding training for prosecutors dealing with victim witnesses; improve the capacity of border and migration police to screen irregular migrants for trafficking indicators; and continue efforts to screen street children for signs of trafficking.

PROSECUTION

The government increased anti-trafficking law enforcement efforts. Articles 110(a) and 128(b) of the criminal code prohibit sex and labor trafficking and prescribe penalties of eight to 15 years' imprisonment; these are sufficiently stringent and exceed those prescribed for other serious crimes, such as rape. The Serious Crimes Prosecutor's Office investigated 25 suspected traffickers in 2015, a decrease from 39 suspects in 2014. The state police also investigated 90 suspected traffickers during the reporting period. The government did not disaggregate law enforcement data to demonstrate efforts against both sex trafficking and forced labor. The government prosecuted 15 defendants in 2015, a decrease from 18 prosecuted in 2014. Courts convicted 11 traffickers, an increase from nine in 2014. All convicted traffickers received prison sentences ranging from six to 17 years, three of which fell below the prescribed minimum penalty of eight years' imprisonment. Authorities continued to prosecute some traffickers for the lesser crime of "exploitation of prostitution" rather than trafficking, because the two laws overlap in some areas. Exploitation of prostitution carries a punishment of two to five years' imprisonment, and up to 15 years' imprisonment under aggravated circumstances, and authorities often applied the lesser charge because it was easier to investigate and prosecute. Some officials also only recognized cases involving cross-border movement as trafficking. Border police continued to screen irregular migrants at the southern border with Greece for trafficking indicators, and in September the government developed a contingency plan to handle the influx of a large number of migrants, which stipulated the screening of all migrants for trafficking indicators. In 2015, the government trained 240 judges, prosecutors, and police officers on investigation and prosecution of traffickers and victim identification and protection. High turnover rates and corruption hampered the efficacy of police training. The government did not report any investigations, prosecutions, or convictions of government employees complicit

in trafficking offenses. Police participated in two multi-national law enforcement operations, which resulted in the arrest of 10 Albanian suspected traffickers.

PROTECTION

The government identified and assisted victims but continued to provide inadequate funding for victim services. The government and NGOs identified 109 victims of trafficking and potential trafficking victims in 2015, a decrease from 125 in 2014. Of these, authorities granted 38 official victim status after they agreed to undergo a formal interview with law enforcement and social services representatives, which was required to obtain this status. The government identified 80 victims; NGOs identified 27; and two victims were self-identified. NGOs reported the lack of government funding for the NGO-led mobile units responsible for most victim identification led to fewer victims being identified. Of all identified victims, 48 were minors and 87 were female. NGOs reported the following trends among the victims assisted by NGO-run shelters: 67 percent of victims were subjected to sex trafficking, nine percent were victims of labor trafficking, and 16 percent were victims of forced begging; 86 percent of victims were exploited within Albania, 12 percent abroad, and two percent both domestically and abroad. Four shelters, three of which were operated by NGOs and one that was state-run, provided assistance to trafficking victims, including food, counselling, legal assistance, medical care, educational services, employment services, assistance to victims' children, financial support, long-term accommodation, social activities, vocational training, and post-reintegration follow-up. However, NGOs reported the government did not provide adequate financial support for the implementation of medical, psychological, and reintegration services. NGO shelters assisted 89 victims, and the state-run shelter assisted 20. The government provided 11,300,000 lek (\$93,000) to the state-run shelter in 2015, a significant decrease from 19,770,000 lek (\$163,000) in 2014. The government did not provide adequate funding to NGO shelters, allocating 3,000,000 lek (\$24,700) strictly for food expenses. However, the government also provided funding for 12 staff member salaries at two NGO shelters and provided funding for renovation of the state-run shelter. NGO shelters continued to operate under severe financial constraints throughout 2015 and relied on outside sources for day-to-day operating costs. Of the 25 million lek (\$206,000) in the government's Special Fund for Crime Prevention, 5 million lek (\$41,000) was disbursed to NGOs to support victims of crime; however, no funds went to support trafficking victim service providers. Only one NGO-run shelter provided specialized services for child trafficking victims, and it continued to operate without adequate funding. Foreign victims had access to the same services as domestic victims, including legal assistance. Male victims were accommodated in apartments paid for by NGOs. The government issued trafficking victims health cards that provide free access to health

care. The government ran a program that incentivized companies to hire former trafficking victims, but observers continued to report some companies forced former victims to work without proper compensation.

Law enforcement and social worker child protection units had a direct role in identifying child victims and ensuring their protection, although they remained underfunded and understaffed. One NGO-operated mobile unit identified 13 potential trafficking victims in 2015, after receiving funding from the Czech government to continue service during the year. NGOs reported, in most cases, authorities did not formally identify victims during investigations, instead labeling cases as “exploitation of prostitution.” This prevented formal interviewing to identify victims, made victims vulnerable to prosecution for crimes committed as a result of their exploitation, and prevented them from accessing trafficking-related services. Victims who testified against traffickers had access to the witness protection program, but no trafficking victims participated in the program, and NGOs reported at least one case where law enforcement discouraged a victim from accessing these services after testifying. Forty-eight victims testified against traffickers. The law provided foreign victims a three-month reflection period with temporary residency status and authorization to work for up to two years, although the government had yet to grant this status to a victim. Victims could obtain restitution from the government or file civil suits against traffickers, but no victims received restitution in 2015. The law exempts victims from punishment for crimes committed as a result of their exploitation, but NGO-run shelters reported the government convicted three formally identified sex trafficking victims in prostitution.

PREVENTION

The government continued efforts to prevent trafficking. The government had a 2014-2017 national strategy and action plan to combat trafficking; however, the plan’s individual stakeholder ministries were underfunded for trafficking activities, and some diverted trafficking funds to other purposes. The government increased funding for the national anti-trafficking coordinator’s office to 5.2 million lek (\$43,000) in 2015 from 4.7 million lek (\$39,000) in 2014. The national coordinator continued to publish regular activity reports on its website and regularly convened stakeholders belonging to the national referral mechanism. Twelve regional anti-trafficking committees comprising local officials and NGOs worked on prevention and victim assistance, but these committees’ nation-wide effectiveness was limited. The national coordinator’s office, the state police, and the general prosecutor’s office signed a memorandum of understanding to monitor the performance of the criminal justice system in handling trafficking cases. The government co-ran and advertised a free hotline and a mobile application for citizens to report suspected trafficking cases. This hotline received 492 calls during

2015, 11 of which provided information on possible trafficking cases. The national coordinator's office ran two major anti-trafficking campaigns during 2015. The first, held from June to August, focused on child sex and labor trafficking and included awareness raising in schools and community centers, discussions with high school students, conferences and seminars with state and border police and social services, and youth awareness meetings that explicitly targeted Roma populations. For the second campaign, the national coordinator's office designated October as Anti-Trafficking Month and organized a series of events with the financial support of NGOs. The government did not demonstrate efforts to reduce the demand for commercial sex or forced labor. The government provided anti-trafficking guidance for its diplomatic personnel, and the national coordinator briefed Albanian diplomats stationed in nine cities on human trafficking regulations.